



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **46**

Prishtinë, më 08.07.2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Liburn Aliu, Ganimete Musliu, Salih Salihu, Salih Zyba, Danush Ademi dhe Etem Arifi.

Munguan: Besa Gaxherri, Lutfi Zharku, Andin Hoti dhe Sergjan Mitrovic.

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje:

Deputetët: Xhelal Sveçla dhe Driton Çausi.

Nga MMPH: Fatmir Matoshi, ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm; Muhamet Malsiu, drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit, Mustafë Hyseni, shef i Inspektoratit; Gani Berisha, u.d. drejtor i Autoritetit Rajonal i Pellgjeve Lumore; Leutrim Sahiti dhe Valon Maliqi, këshilltarë.

Përfaqësuesit e komunitetit nga fshati Biti e Poshtme, Komuna e Shtërpçës: Agron Rushiti, Azem Tahiri, Shpejtim Arifi, Radojica Mrdinac dhe Dobrivoje Stefanoviq.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku e Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 2.7.2019;**
- 3. Raportimi i ministrit të MMPH z. Fatmir Matoshi lidhur me hidrocentralet dhe gurthyesit;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari Nitaj e filloi mbledhjen me diskutimin për Raportimin e ministrit të MMPH z. Fatmir Matoshi lidhur me hidrocentralet, për shkak të prezencës së banorëve të fshatit Biti e Poshtme, ndërsa për gurthyesit do të bëhet në një takim tjetër.

Ai i përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi për pjesëmarrje z. Fatmir Matoshi, ministër i MMPH-së (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) dhe bashkëpunëtorët e tij, përfaqësuesit e

fshatit Biti e Poshtme të komunës së Shtërpcës. Ky është takim informativ për telashet e banorëve që kanë, në lidhje me ndërtimin e Hidrocentraleve (HC), pasi që ne i kemi vizituar dhe në vendin e ngjarjes jemi njoftuar me shqetësimet që kanë banorët e fshatit Biti e Poshtme nga ndërtimi i HC-ve dhe ia kaloi fjalën ministrit Matoshi.

Fatmir Matoshi, *ministër*, në fillim tha se i kuptoj dhe bashkëndjej shqetësimet e banorëve, pastaj shkurtimisht foli për Hidrocentralet të cilat janë duke u ndërtuar nga kompania MATKOS GROUP sh. p. k, në territorin e komunës së Shtërpcës, të cilat janë: *HC Sharri*, është në vazhden e përfundimit të punimeve të veta; *HC Brezovica*, është në përfundim e sipër dhe ka aplikuar për leje mjedisore edhe këtij i janë kërkuar informata shtesë, të cilat ende nuk i ka sjellë; HC Shtërpca, ne rrjedhën e lumit Shtërpcë që posedon dokumente dhe *HC Viga, lumin Lepenc, Viqë* që është në fazën e zhvillimit të punimeve.

Për të gjitha këto HC-e, operatori është i pajisur me dokumentacion përkatës nga MMPH-ja, përkatësisht me Pëlqime Mjedisore dhe Pëlqime Ujore, ndërsa sa i përket lejeve ndërtimore operatori është pajisur me to nga Komuna e Shtërpcës. Për to janë mbajtur debatet publike në 2013 dhe 2014 dhe jemi në një fazë ku unë nuk mundem në mënyrë arbitrare me marrë ndonjë vendim ose me ndërpre punë, sepse investitorët të cilat janë duke punuar, sigurisht që do të kërkojnë dëmshpërblim.

Agron Rushiti, *përfaqësues i komunitetit nga fshati Biti e Poshtme*, fillimisht tha se nuk ka pasur debate publike për këto HC dhe ne, si banorë, nuk kemi marrë pjesë dhe nuk e kemi ditur se çka është duke ndodhur. Ai ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me pakësimin e ujit në lumin Lepenc, duke treguar disa fotografi të lumit para dhe pas ndërtimit të hidrocentralit dhe për pasojë janë duke ngordhur peshqit, pastaj për ujin e pijshëm që është i varur nga Lepenci. Toka jonë është e varur nga ky lumë dhe ne jemi të varur nga bujqësia, janë 100 ha me mjedra të mbjella. *Kryetari, pyeti a e kanë plotësuar standardin e shfrytëzimit të ujit me 30%*, ndërsa, Rushiti tha se absolutisht jo.

Radojica Mrdinac, *përfaqësues i komunitetit nga Shtërpca*, tha se në territorin e Shtërpcës nuk është mbajtur debat publik. Ai përmendi një vendim të Komunës së Shtërpcës për dhënien e tokës në përdorim për ndërtimin e HC dhe pyeti, si mund të jepet pasuria shoqërore në shfrytëzim dikujt pa konkurs dhe konsultim. Pastaj nuk është bërë ndërrimi i destinimit të tokës nga Ministria e Bujqësisë. Ne gjendemi në Parkun nacional të Sharrit dhe si mundet MMPH me dhënë pëlqime me dëmtuar këtë pasuri natyrore e kombëtare dhe në park nuk duhet të ketë hidrocentrale. Sa i përket kërkesave të BE-së për energji të rinovueshme, ai tha se duhet të shfrytëzohet energjia e diellit dhe erës, ndërsa uji për HC të shfrytëzohet nga vendet e tjera, e jo nga parku nacional. Inspektorët e MMPH, duhet të mbrojnë këtë pasuri dhe jo interesat e Matkos grup.

Azem Tahiri, banor nga fshati Biti e Poshtme, shtoi se turizmi në park nacional po vdes nga ndotja dhe degradimi, pastaj me mija hektarë tokë të bukës nuk kemi mundësi me i punuar. Në fund ai i falënderoi komisionin për ftesën, mirëpo tha se duhet pasur kujdes se nëse kërkesat e banorëve nuk realizohen, atëherë jemi të vendosur që këtë problem ta dërgojnë edhe në bashkësinë evropiane.

Liburn Aliu, në takimin që ka pasur me banorët në Biti, në biseda me fshatarët ka vërejtur hezitim të tyre që të shkojnë bashkë te vendi. Ka qenë vetëm njëri i përfaqësuesit të komunitetit serb, dhe disa të komunitetit shqiptarë, të cilët i janë bashkuar. Ata kanë qenë të shqetësuar të duken diku publikisht, për shkak se janë ndjerë të kërcënuar, nëse reagojnë sa i përket çështjes së hidrocentraleve. Është bërë presion mbi ata fshatarë dhe kur këta kanë protestuar, Policia e Kosovës i ka arrestuar, të nacionalitetit shqiptar dhe serb. Policia në këtë rast e ka mbrojtur HC i cili po e varros lumin. Në raport thuhet “operatori ka aplikuar për leje mjedisore dhe ujore dhe ende nuk është pajisur me to”. Pra, operatori i cili e ka bllokuar ujin nuk ka leje ujore. Pastaj iu drejtua ministrit i cili tha se nuk po e mbajmë anën e Matkos-it, por të ligjit. Ky është duke e shkelur ligjin sepse nuk ka leje ujore dhe banorët kanë të drejtë me protestuar, ndërsa policia nuk ka të drejtë me i arrestuar ata. Por inspektorët duhet me marre masa menjëherë.

Ai pati vërejtje edhe ndaj 30% të sasisë së ujit apo minimumit biologjik, për të cilën tha se nuk ka logjikë, pastaj edhe për transparencën e ministrisë tha se mungojnë dokumentet në ëeb-faqe të MMPH, ndërsa në fund tha se Kuvendi duhet me formuar një komision hetues parlamentar për këtë çështje.

Kryetari tha se gjatë vizitës, nuk e kemi gjetur operatorin aty, por aty kemi pa disa njerëz të çuditshëm e të cilët nuk kanë pasur sjellje të mira edhe ndaj deputeteve. Pasi që ministri po thotë se e ka trashëguar një dokumentacion të cilën nuk po mund ta ndërrojë, dhe këtë mund ta bëjë Parlamenti tha se “do të isha shumë i interesuar që Parlamenti i Kosovës ose disa komisione që merren me këtë materie, të krijohet një Komision Hetimor që do t’i futej kësaj problematike në thelb. Mua më duket shumë e dyshimtë, atje duket që diçka mban erë”.

Salih Zyba: Në vizitë që kemi pasur në terren, menaxherin e punëve e kam pyetur pse e keni ndërruar planin e shtrirjes së gypave, ai u përgjigj se për shkak të disa reagimeve të banorëve. Dhe pyeti se si paska të drejtë dikush me ndërruar këtë pa një aprovim të ndryshimit të planit.

Pastaj shtroi edhe disa pyetje: Pas protestave të banorëve ai u ka përgjigj ministria atyre dhe sa herë ka dalë në terren? Cila është vizita e fundit dhe cili është veprimi konkret i MMPH-së? A e keni ndërprerë prodhimin e kundërligjshëm të rrymës? Cili është studimi për prurjet e ujit, që i’u ka parapri pëlqimeve nga ministria; shprehu shqetësimin për mungesën e debateve publike për HC-të dhe pyeti pse kaptimi i ujit po bëhet me sistem të mbyllur e jo me liqej akumulues. Për këto ai, kërkoi përgjigje edhe nga sekretari i MMPH-së, pasi që ministri nuk ka qenë në atë kohë në detyrë.

Salih Salihu, roli i MMPH është me mbrojtur ambientin në këtë rast nga dëmet prej HC-ve që është ndërtuar në zonë të mbrojtur, në anën tjetër ndërtimi i HC-ve është interes për Kosovën për shkak të zëvendësimit të prodhimit të energjisë nga thëngjilli që është ndotëse. Mirëpo sipas gjendjes këtu, vërehet që ministrinë nuk kanë bashkëpunim mes vete. Dhe e përkrahu formimin e komisionit hetimor.

Xhelal Sveçla pyeti a ka shkelje ligjore në ndërtimin dhe në dhënien e lejeve të HC-ve? Pas shqetësimit të banorëve a ka krijuar ministria grup hetimor? A i keni dërguar shkresë ZRRE dhe a keni marrë përgjigje, se a kanë punuar këto HC jashtë kushteve për të cilat kanë marrë leje? Komuna e Shtërpcës ka bërë një ndalesë për këtë HC, dhe sipas komunës MMPH-ja pastaj ka lëshuar një shkresë tjetër e cila ka hedhur atë të komunës?

Driton Çausi, u ndal te raporti për HC Brezovica, ku thuhet se “pas përfundimit të punimeve dhe kryerjes së periudhës testues nga fundi i viti 2017, ndërsa më 08.08.2018, operatori është urdhëruar nga inspektorati i MMPH-së, për të aplikuar për të u pajisur me Leje Mjedisore dhe me Leje Ujore. Mirëpo në bazë të informatave nga departamentet ende operatori nuk është pajisur me Vendim për Leje Mjedisore dhe Leje Ujore.” Dhe kërkoi nga inspektorati që në aspektin procedural të jepet një sqarim, se si për një periudhë të gjatë aty nuk ka pasur fare ndërhyje të inspektoratit d.m.th. pas një viti dhe akoma nuk është pajisë me leje mjedisore.

Ganimete Musliu tha se dje i ka pa që punimet po vazhdojnë në HC në Shtërpcë dhe pasi që ministri tha se nuk është kompetencë e ministrit me i ndaluar, pyeti se kompetencë e kujt është që të vendosë për ndërprerjen e punimeve?

Etem Arifi, për fjalën e ministrit se nuk ka kompetencë me i ndaluar dhe pyeti, “nëse është shkelje ligji për deri sa ju nuk keni qenë ministër, a duhet prapë me vazhduar me shkelje”? Pastaj pyeti a ka mundësi me ndërmarrë diçka ministria, pasi që operatori nuk ka leje mjedisore dhe ujore. Në fund nuk u pajtua me ministrin se “pse fajin ua hodhe deputetëve, pasi që deputetët hartojnë ligje, ndërsa ministria i zbaton ato”.

Danush Ademi, tha se po shihet se ministria nuk ka fuqi për me i ndërpre punimet dhe propozoi që të kërkohet formimi i një komisioni hetimor parlamentar.

Kryetari pyeti banorët se cilat janë kërkesat konkrete të tyre.

Në emër të banorëve, **Radojica Mrdinac**, tha se kërkesat tona janë ndalimi i punimeve në të gjithë lumenjtë dhe shtoi se ka një peticioni të 3500 banorëve që nuk pajtohen me ndërtimin e HC-it dhe deklaratën e të gjithë pronarëve të pronave ku kalon gypi se nuk do të shesin pronën dhe nuk do të lejojnë ndërtimin.

Ministri Matoshi iu përgjigj pyetjeve.

Sa i përket deklaratimeve të banorëve se nuk ka pasur debat publik për HC, në dokumentet që i posedoj debati është mbajtur më 8.5.2013, tha se në rast se vërtetohet ndryshe, atëherë këtu ka një mashtrim dhe dikush duhet të përgjigjet.

Inspektorët e MMPH-së nuk e mbrojnë kompaninë Matkos, por ata janë të obliguar me mbrojtur ligjin.

Në situatën që jemi përveç Parlamentit që mundet me ndërpre, unë nuk e kam fuqinë si ministër me ndërpre sepse njerëzit posedojnë dokumentacione. Ndërsa të gjitha dokumentet janë të hapura për ata që janë të interesuar, dhe në rast se ka pasur shkelje të procedurave diku atëherë përgjegjësia është e tij.

Jam për me garantuar transparencë për të gjitha dokumentet e MMPH-së dhe për të gjitha lejet dhe shtoi se MMPH-a kohëve të fundit e ka ndërruar ëeb-faqen, ndërsa ju vetëm me një email do t'i merrni cilin do dokument që e kërkonte dhe shtoi se në këtë debat ka qenë mirë me të ftohet edhe përfaqësuesi i kompanisë Matkos.

Për minimumin biologjik, mendohet në kohën kur punon HC e jo gjatë sezonës së verës kur bie niveli i ujit, operatori nuk prodhon energji. me dokumentacionin që e ka operatori e ka të ndalur prej 15 qershor deri më 15 shtator prodhimin e energjisë elektrike.

Ka afër 3 muaj që e kam ngritur çështjen e lejeve mjedisore, është e pakuptimtë që në emër të testeve e provave që bëjnë HC-et, me vazhduar me prodhuar dhe me shitë energji për vitet të tëra. Është një problem i grumbulluar me vite dhe kemi filluar me zgjidhë së pari në Deçan jam optimist se do ta zgjidhim edhe në Shtërpcë.

Në bazë të raporteve që kam, nuk ka pasur shkelje ligjore për procedurat sa i përket kompetencave të MMPH-së. Do ta hartojmë dhe do të ju prezantojmë një skicë të kompetencave të secilit institucion për këtë çështje.

Ne nuk i bëjmë pyetje ZRRE-së, ajo iu përgjigjet Kuvendit, i kam shkruar letër në mars ZRRE-së se askush prej HC-ve nuk posedon leje mjedisore dhe fazat e stërzgjatura testuese nuk janë në harmoni me ligjin dhe kam kërkuar prej tyre me ndërmarrë masa. Vetëm ZRRE-ja duhet me ja ndalu operimin. Këtu reagoi **Salih Zyba** dhe kërkoi nga ministri “ndaleni ujin pasi që jeni përgjegjës për mjedis dhe ujëra”.

Punimet nuk ndalen me vizita, theksoi se kjo është kompetencë e deputetëve por deputetet duhet me marrë iniciativë me ndryshuar ligjin dhe një moratorium për me i ndërpre të gjitha deri në nxjerrjen e ligjit, siç është bërë me kazinot, dhe pastaj ministria e zbaton.

Vazhdoi **Arben Çitaku**, dhe tha se leja mjedisore është dokumenti i fundit me të cilin pajiset operatoi në këtë rast HC i cili dorëzohet në ZRRE. Në asnjë rast nuk ka anashkalim të procedurave të parapara me ligj me rastin e lëshimit të pëlqimeve të cilat janë në kompetencë të MMPH-së. Asnjë procedurë nuk fillon në ministri pa u siguruar çështja e pronësisë, pastaj nuk e marrin në shqyrtim pa konfirmimin e komunës përkatës se është në përputhje me planin zhvillimor që ata e parashohin. Asnjë nuk shkon më tutje pa pasur autorizim të ZRRE-së. Prandaj kur operatorët i plotësojnë të gjitha këto kritere, në rast mos shqyrtimit ne bëjmë shkelje ligjore. Çdo HC që është nën 10 MË, lejet e ndërtimit i lëshojnë komunat dhe ata e kanë edhe mbikëqyrjen. Vetëm mbi bazën e ankesës që vijnë në ministri, inspektorët shkojnë në terren dhe për këtë janë procesverbalet.

Jo vetëm pas protestave të banorëve por edhe më shpesh inspektorati i MMPH-së ka dalë në terren, tha **Mustafë Hyseni**, shef i inspektoratit.

Liburn Aliu tha se nëse operatori vepron pa leje mjedisore, nuk mundeni me hedhë fajin te ZRRE-së. Operimi i një HC duhet të bëhet me leje mjedisore dhe ata po operojnë pa të dhe inspektorati duhet ta ndali, për shkak të degradimit të natyrës dhe tharjes së lumit e cila është përgjegjësi e ministrisë e jo e ZRRE-së. Pastaj tha se edhe Kelkosi është duke operuar dhe nuk është ndalë.

Deputeti Salih Zyba kërkoi një sqarim nga ministri Matoshi, se me daljen e Liburn Aliut i cili tha se Kelkos-i ka vazhduar prodhimin e rrymës, çka ka nënkuptuar me atë që tha se “vetëm nëse je ortak, se për ndryshe nuk kishe mund me ditur a është duke punuar apo ngjashëm.

Ministri Matoshi tha se ishte një komunikim jashtë mikrofonit, pasi që Liburn Aliu tha se Kelkosi dje e pardje ka punuar. Përderisa thashë më herët se nuk është duke punuar sepse për këtë çështje kam pasur takime javën e kaluar dhe e di sa dëm u është shkaktuar kompanisë sepse s’është duke punuar, pastaj e kam pyet edhe ambasadorin e Austrisë dy herë për këtë çështje. Ndërsa e pyeta mos është aksionar që po e din që është duke punuar dhe cili është argumenti?

Kryetari i falënderoi për pjesëmarrjen, përfaqësuesve të banorëve të fshatit Biti e Poshtme, ministrin e MMPH-së dhe deputetët.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetari i komisionit,

Muharrem Nitaj